

UDHËZIM
Nr. 3, datë 9.12.2025

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË HOLLËSISHME, KRITEREVE SPECIFIKE SHITESË DHE PROCEDURAVE TË BRENDSHME TË TRAJTIMIT TË KËRKESAVE, QË NDIHMOJNË NË EVIDENTIMIN E KONTRIBUTIT ME INTERES KOMBËTAR NË FUSHËN E ARTIT, KULTURËS DHE SPORTIT

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës; nenit 9, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, të ndryshuar; të pikës 5, të kreut IV, të vendimit nr. 135, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 512, datë 25.9.2025, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit”,

UDHËZOJ:

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i rregullave të hollësishme, kritereve specifike shitesë dhe procedurave të brendshme të trajtimit të kërkesave, që ndihmojnë në evidentimin e kontributit me interes kombëtar në fushën e artit, kulturës dhe sportit.

2. Përveç kritereve të përgjithshme, aplikuesit për fitimin e shtetësisë në programet e veçanta të shtetësisë me interes në fushën e artit, kulturës dhe sportit, plotësojnë edhe kriteret specifike shitesë, si:

a) përfaqësimi ose promovimi i Shqipërisë në skenën ndërkombëtare përmes artit, filmit, muzikës, letërsisë apo formave të tjera kulturore dhe disiplinave sportive;

b) kontributit në krijimin e personave juridikë në fushën e artit, kulturës, sportit dhe mbështetjes së aktiviteteve, programeve, nismave në fushat e sipërpërmendura.

3. Për evidentimin e kontributit me interes kombëtar në fushën e artit, kulturës dhe sportit ndiqet procedura e brendshme, si më poshtë:

a) drejtoria përgjegjëse pranë ministrisë përgjegjëse për artin, kulturën dhe sportin regjistron menjëherë kërkesat e ardhura nga Agjencia e Posaçme për Programet e Shtetësisë (AHVPSH);

b) ministri ngre një komision *ad-hoc*, për vlerësimin e aplikimit në aspekt të kontributit me interes kombëtar në fushën e artit, kulturës dhe sportit;

c) pas përfundimit të shqyrtimit, grupi i punës i paraqet ministrit për miratim raportin përfundimtar, i cili përmban:

i. përshkrimin e kontributit të aplikuesit në një nga fushat;

ii. dokumentacionin mbi të cilin bazohet vlerësimi;

iii. qëndrimin lidhur me evidentimin ose jo të kontributit në fushën e artit, kulturës dhe sportit;

iv. rekomandimin për miratimin ose mosmiratimin e propozimit për dhënie shtetësie.

4. Struktura përgjegjëse kujdeset për dërgimin e shkresës së arsyetuar për vlerësimin e kontributit në zbatim të afateve të përcaktuara në shkronjën “c”, të pikës 3, të kreut V, të VKM-së nr. 135/2024, të ndryshuar.

5. Ngarkohet struktura përgjegjëse për politikat e trashëgimisë kulturore, zhvillimit të arteve dhe politikave të sportit dhe anëtarët e grupit *ad-hoc* për zbatimin e këtij udhëzimi.

6. Ngarkohen strukturat e përcaktuara për zbatimin e këtij udhëzimi, si dhe Sektori i Arkiv-Protokollit për komunikimin e tij.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
Blendi Gonxhja